



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 872/Prot.  
17

Tiranë, më 3/7/2017

REKOMANDIM

Nr. 26 datë 3/7/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje*, Kamëz-Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.148, datë 30.05.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje*, Kamëz-Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje*, Kamëz-Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.148, datë 30.05.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, është institucion i përkujdesjes sociale rezidenciale, në varësi direkte të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, misioni i së cilës ka për qëllim të ofrojë nëpërmjet shërbimeve, ndërhyrjes dhe trajtimit në programet kundër dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe të fëmijëve të tyre duke rritur në të njëjtën kohë llogaridhënien e abuzuesve për dhunën që është ushtruar.

Ky kontrollues gjatë ushtrimit të detyrës, mbledh të dhëna personale, të kategorive "përfitues" dhe "punëmarrës" si: gjeneralitete, dhe më së shumti të dhëna personale sensitive, duke filluar që nga formulari i pranimit, duke vazhduar me një sërë formularësh për: vlerësimin shëndetësor, vlerësimin ligjor, vlerësimin psiko-social, vlerësimin financiar, vlerësimin e nevojave arsimore profesionale, vlerësimin e rrezikut/vdekshmërisë, akomodimin, sigurinë, monitorimin afat-gjatë pas daljes nga qendra pritëse etj.

Një nga parimet bazë të aktivitetit të kontrolluesit sanksionuar në akte nënligjore, (*Botimi Standard mbi shërbimet e përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike & Rregullore funksionale e kontrolluesit Q.K.T.V.DH.F.*), është konfidencialiteti.

#### **Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Nga verifikimi në regjistrin elektronik të kontrolluesve pranë Zyrës së Komisionerit, kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, nuk e ka kryer detyrimin për njoftim.  
Konstatimi i pikës 1, përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të ligjit - *"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*.
2. Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, ka disa formate mbi konfidencialitetin, për vizitorë dhe punëmarrës, dhe palë të treta. Pajisja me Deklaratë Konfidencialiteti e punëmarrësve që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës, është detyrim ligjor dhe ka standardin e parashikuar në aktin nënligjor, Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, si dhe masat për shpërdorimin e tyre.**  
Gjithashtu, kjo deklaratë merr fuqi provuese dhe ligjore nga nënshkrimi (emri dhe firma) i punëdhënësit, pjesë e detyrueshme e kësaj deklarate.  
Konstatimi i pikës 2, përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit - *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"*.
3. Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, nuk ka një rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, përveç aneksit 4, sipas udhëzimit Nr.13, datë 17.12.2012, i cili është përfshirë në Botimin Standard mbi shërbimet në për-kujdesin shoqëror, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.  
Konstatimi i pikës 3, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, - *"1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.*  
*2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:*

*2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.*

4. Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, nuk ka një rregullore të mirëfilltë për funksionimin e kamerave në ambjentet e tij dhe tabela e informimit nuk është konform standartit të parashikuar në Udhëzimin Nr.46 datë 26.03.2017 të Komisionerit.

Konstatimi i pikës 4, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar, si më lart cituar në pikën 3.

5. Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, në marrëdhënien juridike me palën e tretë, mirëmbajtësin e sistemit të kamerave CCTV, dhe njëkohësisht ofrues i shërbimit të sigurisë, nuk ka marrëveshje konfidencialiteti sipas Udhëzimit Nr.19 datë 03.08.2012 të Komisionerit, por aplikon një deklaratë konfidencialiteti të thjeshtë, në të cilën nuk janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Konstatimi i pikës së pestë, përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, – *“1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:*

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;*
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;*
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;*
- d) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit.*
- e) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.*

*2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar e kontrolluesit me përpunuesin.”*

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, të realizojë detyrimin për njoftim dhe në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, të hartojë dhe përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".
3. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, të hartojë rregullore për funksionimin e kamerave në ambjentet e tij, si dhe të standardizojë tabelën e informimit mbi prezencën e sistemit të kamerave CCTV, konform Udhëzimit Nr.46 datë 26.03.2017 të Komisionerit.
4. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, të marrë masa për të pajisur me Deklarata Konfidencialiteti të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës pranë këtij kontrolluesi, sipas standardit të parashikuar në Udhëzimin Nr.19 datë 03.08.2012 të Komisionerit.
5. Kontrolluesi *Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje* Kamëz-Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 3, dhe 4 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 3/72017

BESNIK DERVISHI  
  
KOMISIONERI